



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:057132
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05407717

PPP.nr.18/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike të kreditorit, NTP “C.....” me seli në Prizren me pronar F.M., të cilin me autorizim e përfaqëson avokat A.H., nga Prizreni, kundër debitorit, NPN “Ç.....” me seli në Korishë-Prizren, me pronat S.D., nga fshati Korishë Komuna e Prizrenit, në bazë të dokumentit të besueshëm të përbarimit – faturave, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 565.078.40 euro, lejuar me Urdhrin për përbarim, P.nr.304/2019 të dt.08.08.2019 të Përbaruesit privat Mehdi Reshani nga Prizreni, duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit, për përjashtimin e përbaruesit privat, jashtë seancës, më datë **05.03.2024, mori këtë:**

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET e pabazuar kërkesa e datës 01.02.2024 e debitorit, S.D., nga fshati Korishë Komuna e Prizrenit, për përjashtimin e përbaruesit privat Mehdi S. Reshani nga Prizreni, si organ i autorizuar përbarues për të vendosur në lëndën e përbarimit P.nr.304/2019, P.nr.158/2020 dhe P.nr.225/2020.

A r s y e t i m

Organi përbarues, përbaruesi privat, Mehdi Reshani nga Prizreni, me Urdhrin e tij për përbarim, P.nr.304/2019 të dt.08.08.2019, ka lejuar propozimin për përbarim të kreditorit të përbarimit, NTP “ C..... NITI ” me seli në Prizren, me pronar F.M., të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H., nga Prizreni, të paraqitur ndaj debitorit, NPN” Ç.....”, me seli në Korishë-Prizren, me pronar S.D., nga fshati Korishë Komuna e Prizrenit, në bazë të dokumentit të besueshëm të përbarimit – faturave, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 565.078.40 euro, si dhe shpenzimet e caktuara të përbarimit.

Debitori S.D., nga Fshati Korishë Komuna e Prizrenit, pranë përbaruesit privat, Mehdi S. Reshani nga Prizreni, më datë 01.02.2024, ka bërë kërkesë për përjashtimin e këtij përbaruesi

privat, për lëndët P.nr.304/2019, P.nr.158/2020 dhe P.nr.225/2020, për shkak të rrethanave se me veprimet e tij nuk është i paanshëm dhe objektiv në vendosje në këto çështje përmbartimore, tutje ka shtuar se përmbartuesi privat Mehdi Reshani, ka lejuar propozimet e kreditorit të përmbartimit me urdhra P.nr.304/2019, P.nr.158/2020 dhe P.nr.225/2020 për shkak të detyrimit në të holla, organi përmbartues ka ndërmarrë në vazhdimësi veprime përmbartimore mirëpo nuk ka respektuar dinjitetin e debitorit ashtu siç e parasheh dispozita e nenit 9 të LPP-së, dhe i njëjti nuk ka vepruar që sa më pakë të dëmtoj debitorin e përmbartimit, me tej ka shtuar se shkak për përjashtim të përmbartuesit është edhe miqësia e tyre e vjetër me kreditorin F.M., dhe fakti tjetër që duhet merret parasysh lidhur me përjashtimin e përmbartuesit edhe mbajtja e seancës së ankandit publik, duke mos njoftuar paraprakisht bashkëpronarët e paluajtshmerisë së hipotekuar dhe me këtë ka bërë shkelje procedurale dhe me qëllim që të paluajtshmeritë lëndore ti shes kreditorit, me qëllim që të mos pranoj ndonjë ofertë nga bashkëpronarët e tjerë.

Përmbartuesi privat Mehdi Reshani nga Prizreni, me datën 07.02.2024, ka dhënë Deklaratë për Përjashtimin e Përmbartuesit privat, dhe me aktin përcjellës të datës 12.02.2024, shkresat e lëndës ja ka përcjellë Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti të Përgjithshëm, në kompetencë për vendosje.

Kjo gjykatë, duke vlerësuar të gjitha shkresat e lëndës përmbartimore, P.nr.304/2019, dhe P.nr.158/2020 dhe P.nr.225/2020, dhe pretendimet e debitorit Sami Dakaj, të cekura në kërkesën e tij për përjashtim të përmbartuesit privat Mehdi S. Reshani, ka gjetur se kërkesa e lartcekur për përjashtim **është e pabazuar**.

Në këtë drejtim, gjykata vlerësoi si të pabazuar pretendimin e palës debitore se, përmbartuesi privat Mehdi S. Reshani, ka mbajtur seancën e ankandit publik duke mos njoftuar bashkëpronarët e paluajtshmerisë së hipotekuar, dhe me këtë ka bërë shkelje procedurale, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar, pasi që përmbartuesi privat në seancën e datës 26.08.2022, ka konstatuar se ka kushte për mbajtjen e seancës së ankandit publik verbalë, për arsye se tre bashkëpronarët V.D., H.D., I.D., jetojnë në botën e jashtme dhe e ka njoftuar të autorizuarin e kreditorit që duhet të paraqitet propozim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm nga radha e avokatëve për të njëjtit, me këtë përmbartuesi ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP-së. Ndërsa pretendimi tjetër i debitorit lidhur me jobjektivitetin e përmbartuesit privat pasi që i njëjti ka miqësi me kreditorin, ky pretendim i debitorit është i pa justifikuar, pasi që përmbartuesi privat në deklaratën e tij ka deklaruar se, se kjo miqësi nuk ekziston si shkak ligjor i paraparë sipas nenit 67 pika g lidhur me nenin 17 dhe nenin 325 të LPP-së, kështu, veprimet e përmbartuesit privat si organ i përmbartimit, janë tërësisht të lejuar dhe nuk paraqesin kurrfarë shkelje ligjore sipas dispozitave në fuqi. Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve dhe arsyeve, gjykata erdhi në përfundim që pretendimi i palës debitore është i pabazuar dhe nuk ka mbështetje juridike.

Gjithashtu, pretendimi i palës debitore që përmbartuesi privat e ka shkel nenin 9 të LPP-së, një pretendim i tillë nuk ka kurrfarë mbështetje ligjore, andaj sipas arsyeve dhe fakteve të cekura më lartë, këto pretendimet janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se përmbartuesi privat ka vepruar konform dispozitave të LPP-së.

Së këndejmi, sipas nenit 325 par. 1-3 të LPP-së thuhet se: “Dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve vlejnë përshtatshmërisht edhe për përjashtimin e përmbaruesve privat. Gjyqtari i Gjykatës Themelore brenda territorit të cilit është emëruar përmbaruesi privat, vendos për kërkesën për përjashtim. Nuk do të lejohet asnjë ankesë kundër aktvendimit i cili aprovon apo hedh poshtë një kërkesë për diskualifikimin e një zyrtari privat të përmbarimit”. Më tutje, në nenin 67 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), që ka të bëjë me përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi, thuhet se: “Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike: ... g) në qoftë se ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij”. Në rastin konkret, pala debitorë, ka kërkuar përjashtimin e përmbaruesit privat, Mehdi S. Reshani nga Prizreni për të vendosur në çështjen juridike të përmbarimit, P.nr.304/2019 dhe në lëndët tjera P.nr.158/2020 dhe P.nr.225/2020, ku debitori është palë në këto çështje, dhe pretendimet e debitorit se ky përmbarues privat si organ i përmbarimit, është jo objektiv dhe nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP-së. Mirëpo nga gjendja e shkresave të lëndës, kjo gjykatë ka gjetur se ky pretendim i palës debitorë, nuk është i bazuar në ligj dhe nuk ka mbështetje ligjore, dhe se sipas gjendjes së tanishme të shkresave të lëndës P.nr.304/2019 dhe P.nr.158/2020 dhe P.nr.225/2020, nuk mund të provohet se në rastin përkatës të përmbaruesit privat Mehdi S. Reshani nga Prizreni, ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e tij, si dhe nuk është provuar se ka pengesë ligjore që ky përmbarues privat të veprojë në këto lëndë përmbarimore të cilat zhvillohen pranë organit përmbarues. Andaj, duke marrë për bazë dispozitat e lartcekura ligjore dhe shkresat e lëndëve, gjykata ka vlerësuar se, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për përjashtimin e përmbaruesit privat, Mehdi S. Reshani nga Prizreni, si organ përmbarues për të vendosur në këto çështje juridike të përmbarimit, sipas arsyeve të cekura më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të thënat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në bazë nenit 3, 17 dhe nenit 325 të LPP-së, lidhur me nenin 67 par. 1 pika g) të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.18/2024
Datë 05.03.2024

Gjyqtari
Sami Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.